

FATOS KONGOLI

VEPRA

NE TË TRE

ROMAN

1

BOTIMET TOENA

FATOS KONGOLI

VEPRA

1. Ne të tre - *roman*
2. I humburi - *roman*
3. Kufoma - *roman*
4. Dragoi i fildishtë - *roman*
5. Ëndrra e Damokleut - *roman*
6. Lëkura e qenit - *roman*
7. Te porta e Shën Pjetrit - *roman*
8. Jetë në një kuti shkrepësesh - *roman*
9. Në pritje të Nostradamusit - *tregime*
10. Karuseli - *roman*
11. Bolero në vilën e pleqve - *roman*
12. Iluzione në sirtar - *autobiografi*
13. Si-do-re-la - *roman*
14. Njeriu me fat - *roman*
15. Gjemia e mbytur - *roman*
16. Gënjeshtarë të vegjël - *roman*
17. Kapitulli i Amerikës - *autobiografi*
18. Stinë pandemie - *roman*
19. Misteri i mjellmës - *roman*
20. Ballo me maska ose shakaja e fundit - *roman*

FATOS KONGOLI
VEPRA

NE TË TRE

roman

1

BOTIMET TOENA

Botim i veçantë në kuadër të Veprës.

Botuese: Irena Toçi

Korrektore letrare: Dorina Talo

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Gea Qëndro

ISBN 9789928960924

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

PJESA E PARË

KAPITULLI I

Ai erdhi tek unë papritur, mbase në një kohë të papërshtatshme. Prej dy orësh qëndroja përpara tryezës së punës i kërrusur mbi fletën e bardhë, të cilën, në vend të fjalëve, e mbushja me shkarravina. Koka më dhimbte, një turbullirë më rëndonte qepallat. Por më tepër ndieja keqardhje.

Atëherë kisha botuar disa tregime, që u përmblodhën në një libërth të vogël. Dhe kujtova se u bëra shkrimtar. Ky iluzion u tret sapo mora një leje krijuese. Kisha përgatitur skica, makete tregimesh, planin e një novele. Po, kur zura t'i hidhja, ato m'u mërzitën, m'u dukën gjëra pa vlerë. Me një fjalë kuptova se po harxhoja kot edhe kohën, edhe nervat.

I hutuar nga ky zbulim, rrija përpara fletës së bardhë duke shkarravitur. Prandaj tringëllima e ziles së korridorit atë pasdite vonë më ngacmoi. Vendosa të mos e hapja derën. Të ishte kush të donte. Mirëpo zilja vazhdoi të këmbëngulje. Unë shtrëngova

kokën midis duarve. Gruaja dhe djali ndodheshin në plazh, të afërmit dhe miqtë ma dinin hallin, madje, para se të nisej, gruaja e pa të arsyeshme të njoftonte edhe fqinjët. Kështu që askush nuk vinte për vizitë.

Si tani më shfaqet para syve fytyra e tij me tiparet e njohura. Në gjysmerrësirën e shkallës ato m'u dukën të largëta. Disi i shtangur e vështrova nga këmbët te koka, pa mundur të shqiptoja ndonjë fjalë, qoftë për mirësjellje.

-E shoh, - tha më në fund, - ti më ke harruar fare.

Me gjithë përpjekjen për t'u treguar i përzemërt, ftesa që i bëra të futej brenda tingëlloi ftohtë. Ai, si të mos kishte vënë re asgjë, me një buzëqeshje të lehtë në fytyrë, më ndoqi nga pas.

Dhoma, në rrëmujë të plotë, qe mbushur me tym duhani. Tërë gardëroba ime verore ekspozohej në kanape e sipër kolltukëve. Copëra dorëshkrimesh të grisura, të mbledhura shuk, shpërndaheshin qosheve, mbi parket, mbi tryezën e punës, ku tavllat e cigareve qenë mbushur plot bishta të thithur gjer në fund apo të shuar përgjysmë.

Aiqëndrojnë më të dhomë sipashqetësuar nga kjo rrëmujë. Pastaj, me dy gishtërinj zuri këmishën time mbi një kolltuk, e hodhi tutje, u ul, mbështeti çantën te këmbët dhe,

me tonin e një njeriu i cili të ka bërë vizitë vetëm para pak ditësh, tha:

-E qartë, i njëjti shkatarraq si gjithmonë. Mos të ndërpreva punën?

-Fred, -mërmërita unë duke ndier vështirimin e ngulmët të syve të tij, -po ku drejtin ke humbur gjithë këtë kohë?

Miku im pothuaj nuk kishte ndryshuar. Afër të tridhjetave, me trupin e gjatë e të rregullt, pa asnjë shenjë trashjeje, ai dukej si djalosh. Po ajo shprehje e përqendruar, po ata flokë gështenjë, të dendur e të prerë shkurt, po ata sy të vëmendshëm.

-Mbase nuk më beson, - i thashë tek sillja një shishe me konjak, - kushedi sa herë më ka vajtur mendja te ti. Sikur të përpiu dheu, sikur u zhduke në një planet tjetër.

-Nuk kam qenë aq larg, vetëm mali i Kërrabës na ka ndarë.

-Këtë e di, - iu përgjigja tek hapja shishen.

- Po si është e mundur që s'jemi parë? Për këtë fajtor je ti. Ai qeshi. Zuri gotën dhe e trokiti me timen.

-Për takimin tonë! - tha dhe e ktheu me fund. Pastaj, si u rehatua në kolltuk, vazhdoi: - Për sa i përket se kush e ka fajin, kjo është vështirë të gjendet. Unë për shembull di gjithçka rreth teje, të kam lexuar edhe librin.

Në zërin e tij të shkujdesur fshihej një nëntekst ironie.

-E tepron, - i thashë, - i zmadhon gjërat. Unë s'jam veçse një asistent që jep seminare. Për sa u përket shkrimeve... Po më mirë ta lemë këtë. Të them se të prisja të gënjej. Dhe di shumë më pak për ty nga ç'ditke ti për mua. Mos duhet të më mbash inat?

-Të marrtë dreqi, kështu do të mbetesh gjersa të vdesësh. Po si të shkon në mendje një gjë e tillë?

Pas kaq vitesh ndjeva në veten time lidhjen tonë të vjetër, të pazhvlerësuar nga koha. Ndjeva se ai vazhdonte të më donte, se kisha mbetur për të po ai shok i afërt, ndonëse shumë ujë kishte rrjedhur. Dhe më erdhi keq, s'di përse më erdhi keq.

-Ti ke të drejtë të ankoresh ndaj meje, -i thashë. - Duhet të pranoj, në njëfarë mënyre mua jeta më ka përkëdhelur, në kuptimin se gjërat më kanë ardhur të kollajta... Unë nuk kam pasur peripecira, po të mos quajmë të tilla vogëlsirat e përditshme. Kurse ti...

Fredi qeshi.

-Pse qesh? -e pyeta. -Apo kujton se po tregohem hipokrit?

Ai u ngrit në këmbë, zuri të vinte rrotull meje, që kisha mbetur në pupën e vogël pranë tryezës.

-Ti i tragjedizon gjërat më kot. Në qoftë se do të ishe nga ata tipa bosh, që ecin me patericat e të tjerëve, atëherë mund të të vriste ndërgjegjja. Por të tillë tipa zakonisht

nuk kanë brejtje ndërgjegjeje dhe s'bëhen fort merak se ç'mund të mendojnë të tjerët.

U ul, mbushi gotën me konjak dhe me vështroi me dinakëri.

-Vë bast se edhe në dashuri të ka ecur po aq kollaj sa ç'thua!

- Jo, - e kundërshtova. - mos u tall. Jam martuar shpejt, me të mbaruar fakultetin.

- Unë nuk po tallem, - tha ai, - madje të kam zili. Pastaj i hodhi një vështrim orës.

-Më duhet të ngrihem.

- Si të ngrihesh, - kundërshtova unë për këtë kthesë të papritur. - Ti do të rrish sonte. Kemi kaq kohë pa u parë.

-Jo, për sonte kam zënë hotel dhe më duhet të vete diku. A s'më thua, - shtoi pas pak, -ç'datë është sot?

-Në mos gabohem, sot është e enjte, datë 28 gusht 1980.

-Pikërisht, - tha ai, - kurse pasnesër është e shtunë, datë 30 gusht 1980. Nuk të kujton gjë?

Duke e hetuar me njëfarë dyshimi, unë u përpoqa të sillja ndër mend ndonjë ngjarje që mund të lidhej me këtë datë.

-Jo, - i thashë, - asgjë nuk më kujtohet. Mos është ditëlindja jote? Fredi lëshoi një pasthirrmë.

-Dhe unë do të merrja rrugët midis kësaj vape për diçka kaq të parëndësishme!

Ai u përkul, hapi çantën që e kishte mbështetur në këmbët e kolltukut dhe

nxori prej andej një fotografi të madhe. Ia rrëmbeva nga duart. Atëherë dhjetëra sy të njohur më përpinë.

Për besë, - gati sa s'thirra, - kjo është fotografia jonë e maturës.

- Shikoje mirë, aty ndodhet një shënim i thjeshtë: Takimi pas dhjetë vjetësh. Kjo datë bie pasnesër.

Gjëra të tilla nuk i kisha marrë kurrë seriozisht. Me siguri duhej ta ruaja edhe unë një kopje të kësaj fotografie. Por s'besoja se pas dhjetë vjetësh dikush do ta fshinte nga pluhuri. Pjesa më e madhe e shokëve ishin shpërndarë. Pak djem ndodheshin në Tiranë, kurse vajzat ishin martuar të gjitha. Kujt tjetër do t'i binte ndër mend për këtë premtim të harruar? Megjithatë, i përfshirë nga kureshtja, e lexova edhe një herë.

-Ti mendon se mund të bëhet ky takim?
- e pyeta. - Mua më duket e pamundur, sidomos tani, në sezon pushimesh.

Ai sajoi një buzëqeshje të hidhur. Se ç'kishte në atë shprehje të fytyrës së tij, diçka të shpërqendruar.

- E ke gabim, - tha, - shumica e shokëve do të vijnë. Që të bindesh, lexo dhe këtë.

Ndërkaq kishte nxjerrë nga çanta një copë letër. Më bëri përshtypje mënyra sesi ishte palosur ajo, në formë trekëndëshi, tamam si pusullat që i dërgonim dikur njëri-tjetrit. Ndërsa Fredi, po më shihte përmes

shtëllungave të tymit, unë zura të lexoja me zë të lartë: “Mikut tim inatçi, shokut Fredi Simaku! Jam i sigurt se ende nuk ma ke falur incidentin famëkeq të kokës së lakrës, por shpresoj që kjo letër më në fund të t’i ulë nervat. Për këtë mjafton të nxjerrësh nga valixhja një fotografi, kopjen e të cilës po e mbaj tani përpara syve. Ke dalë tamam si spec i mbushur. Nëse nuk të pëlqen krahasimi, aq më bën. Aty poshtë, në qoshe, ndodhet një shënim: Miqtë e vërtetë i mbajnë premtimet. Nja dhjetë vetave u kam shkruar. Pra mirupafshim më 30 gusht 1980, përpara Monumentit të Skënderbeut, në orën 7 të mbrëmjes. Lum ata që do të vijnë me rimorkio. Mjerë beqarët e përjetshëm. Inxh. Artan Kondili d.v. Fierzë”.

Këtë radhë ia krisa unë gazit. “Incidenti famëkeq” kishte ndodhur në një nga pushimet e gjata midis orëve, kur Artani i ngjeshi Fredit në kokë një lakër të prishur.

- Po qe puna kështu, s’kam kundërshtim, -thashë unë.

Fredi u ngrit. Ngula këmbë shumë që ta mbaja atë natë, por ai nuk qëndroi. E lamë të shiheshim të nesërmen pasdite, në lokalin e hotelit “Arbëria”.

Ai zbriti shkallët dhe u zhduk në errësirë. Unë u ktheva në dhomë. Pa vetëdije mblodha dorëshkrimet e shpërndara andej-këndeje, të cilat i hodha në kosh. Pastaj hapa

dritaren. Tutje, në sheshin e madh para pallatit, rrëzë pishave të zhytura në muzgun e mbrëmjes, shquheshin silueta njerëzish. S'di sa qëndrova ashtu, i përhumbur, midis realitetit dhe ëndrrës, nën pushtetin e mbresave të dikurshme.

KAPITULLI II

Ja shtëpia e fëmijërisë, e mbuluar me tjegulla të kuqe. Dhe babai me shkallën e vjetër, të cilën e përdorte të dielave, sa herë i duhej të zinte vrimat e çatisë. Një kumbull midis oborrit, pjergulla që kacavirrej në drurin e saj.

Të gjitha u zhdukën papritur, edhe shtëpia, edhe pjergulla, edhe kumbulla. Një makinë na çoi diku, në skajin tjetër të qytetit. Shkallët e pallatit të panjohur gëlltitën sendet e tona dhe i mbyllën në dhomat e një apartamenti të katit të dytë, së bashku me të qarat e Gjergjit, vëllait tim të vogël, të cilit, gjatë transportit, i humbi pushka prej kauçuku.

Atë mbrëmje mëma i ra pianos. Gjysmë i përgjumur unë ndiqja lëvizjen e gishtave të saj mbi tastierë. Atëherë ajo përgatitej për koncertin e ardhshëm dhe ne mezi e pritnim.

Ja dhe vajtja ime e parë në opera. Një abazhur gjigant kristali varej në kupolën e

lartë e ndriçonte tërë sallën. Nga gropa nën skenëvinintingujttëçrregulltinstrumentesh, që përziheshin me mërmërimën e publikut. Dalëngadalë mërmërimat u shuan, dritat zunë të veniteshin. Midis qetësisë së thellë që pllakosi, ndërsa projektorët hodhën tufat e tyre mbi perden e skenës, u ndien hapa. Si i magjepsur unë zgjata kokën. Një burrë i shkurtër përshëndeti sallën duke u përkulur lehtë. Pastaj perdja e trashë ngjyrë vishnje filloi të lëvizte dhe në mes të skenës, përpara një pianoje të gjatë me kapak të ngritur pashë nënën time. Ajo vështronte diku lart. Veshur kështu, me atë fustan të bardhë gjer në fund të këmbëve, e kisha parë shpesh në një fotografi, që prindërit e mbanin mbi komodinë, në dhomën e tyre të gjumit. Por në skenë ishte ndryshe. Dhe më erdhi inat që gjithë këta njerëz shihnin nënën time, më erdhi inat që ajo u buzëqeshte atyre dhe s'kujtohej fare për mua.

Vetvetiu u ktheva nga babai. Mbështetur në shpinë të karriges, pakëz i tërhequr nga buza e lozhës, ai ndiqte lëvizjet e burrit të shkurtër, i cili më në fund ngriti duart përpjetë. Nëna kishte zënë vend në fronin pranë pianos. Dëgjova të pëshpëritej një emër që m'u ngulit përgjithmonë: Pjotër Iliç Çajkovski.

Burri tundi shkopin. Në sallë u derdh një valë tingujsh. Me lëvizjen e tij ai sikur

kishte bërë një të çarë diku. Tingujt vërshuan të papërmbajtur. Në fillim si një rrëke e vrullshme që shumë shpejt e zgjeroi shtratin, u kthye në një lumë plot dallgë, mbi të cilin voziste një varkë. Në fantazinë time ajo përplasej , hidhej përpjetë, zhdukej sikur të qe mbytur, pastaj dilte përsëri mbi kreshta, sulej përpara në mugëtirë dhe papritur kuptova se varka e fantazisë sime s'ishte veçse pianoja, tingujt e pianos. Ata dilnin e fluturonin nga majat e gishtave të nënës, përziheshin në vorbullën e veglave të tunxhit, vraponin të shqetësuar, herë të përhumbur, herë me klithma, gjersa unë ndjeva marshin e tyre triumfal, kur salla u ngrit në këmbë me duartrokitje.

Asnjëherë tjetër nuk jam kënaqur si në këtë koncert të parë. Me këmbënguljen e nënës nisa të shijoja e në njëfarë mënyre ta njihja muzikën, ndonëse kurrë nuk u bëra as pianist, as violinist, siç donte ajo. Fare i vogël kisha filluar të luaja diçka në piano, por u pa shpejt se më mungonte edhe talenti, edhe durimi. Orët e gjata të ushtrimeve më mërzitnin, dalëngadalë m'u kthyen në torturë. Gjithnjë e më tepër nëna i ankohej babait se unë po ia plasja shpirtin me plogështinë time. Dhe kur Gjergji zuri të tregonte priroje të veçanta për muzikë, interesi i saj ndaj meje u shua. Babai vërejti se kundërshtimi i tij disa vite më parë për

të më futur si nxënës të rregullt në liceun artistik, tashmë, ishte përligjur.

Poshtë nesh, në katin e parë banonte Artan Kondili. Ai vinte i treti midis pesë fëmijëve të familjes së tij të madhe. I shkurtër, me flokët që i rrinin përpjetë si gjemba, Tani ishte kapoja i moshatarëve që mblidheshin në sheshin para pallatit. Ndërsa Gjergji torturohej pasditeve me violinën (gjithmonë e përfytyroj përpara pupitrës, duke luajtur koncertin e Vivaldit), ne hazdisnim. Qëndrimi i prindërve ndaj meje dhe Gjergjit ishte krejt i ndryshëm. Me pak përjashtime, unë isha i lirë të bëja ç'të doja, kurse Gjergji i nënshtrohej një kontrolli të rreptë. Në shtëpinë e Tanit, në dhomën ku flinin fëmijët qenë vendosur dy krevate marine dhe një shtrat tek. Nëna e tij, një grua e trashë me duar të fryra, ishte kuzhinierë. Ajo dukej tamam si top me dhjamë, aq e bardhë e rrumbullake ishte. Veçse shuplakat i kishte të forta. Fëmijët më shumë i trembeshin asaj, sesa babait të tyre shofer, të cilin e shihja rrallë. Ai qe një burrë i zeshkët, i thatë, sikur shëndetin t'ia rrëmbente e shoqja, që vazhdimisht zbardhej e ngjallej, kurse ai vetëm nxihej e thahej.

Kur kthehej i ati nga udhëtimet, unë nuk shkoja në shtëpinë e Tanit. Por, kur ai nuk ndodhej aty, shkoja shpesh, sidomos mbrëmjeve. Atëherë e ëma më detyronte të

haja së bashku me fëmijët e tjerë, në një tryezë të gjatë, ku secili ulej në vendin e vet.

Asnjëri prej tyre nuk vuante nga mungesa e oreksit, siç ndodhte me mua. Nëna e Tanit më thoshte se unë, biri i farmacistit, duhesha rrahur përderisa ime ëmë më ushqente me gjithë të mirat e unë po shkop i thatë kisha mbetur. Ajo përdorte edhe epitete të tjera për të më treguar se sa shëndetlig isha, përmendte dënime të tilla si fshikullimi me hithra, dhe këto i thoshte aq seriozisht, sa të vegjlit mbeteshin gojëhapur e më vështronin sikur atë çast nëna e tyre vërtet do të më përvishej me hithra.

Nuk ishin këto që më tërhiqnin në shtëpinë e Tanit. As përrallat me të cilat Xheja (kështu e quanin gruan) nanuriste të vegjlit para se t'i vinte në gjumë. Unë shkoja atje se ndihesha i lirshëm. Përkëdheljet e Xhejes, në qoftë se mund t'i quajmë të tilla, ishin krejt të veçanta. Ajo sillej me fëmijët si me vëllezërit e motrat më të vogla dhe ata nuk e thërrisnin nënë, por thjesht Xheje. Aty unë harroja se isha i vogël, se nuk duhej të bëja veprime që mund të mos u pëlqenin të mëdhenjve. Fitoja besim në vetvete, i cili më lëkundej sapo ngjitesha një kat më sipër e trokisja në derën time.

Kujdesesha t'i shmangesha vështrimit të nënës, por kjo s'më ecte. Me t'u hapur dera, heshtja e apartamentit tonë më shtypte. Kthehesha në fëmijë, në një qenie

të druajtur. Sipas nënës, perspektiva e vetme që mbetej para meje ishte të bëhesha karrociër. Unë nuk shihja asgjë të keqe në këtë mes, prandaj ajo tronditej.

Babai i ndiqte skenat midis nesh me qetësinë e tij të zakonshme. Me sa dukej ai s'gjente ndonjë arsye për të më qortuar, me përjashtim të rasteve kur shkoja në lumë. Nuk mund të më përkrahte gjer në këtë pikë. Për sa u përket të tjerave, kisha dhënë prova se dija të sillesha. Kjo ndodhte sidomos në raste vizitash, sidomos kur te ne vinin prindërit e Robert Kasimatit, njërit prej të njohurve të mi më të vjetër.

Njohjen me Robertin e mbaj mend mirë, me të lidhen disa ngjarje që s'mund të harrohen. Duhet të ketë qenë viti 1960, sepse sapo kisha hyrë në klasë të parë.

Prej disa ditësh rrija shtrirë në krevat i sëmurë, me tmerrin e gjilpërave. Një pasdite prindërit më mbështollën me batanije kokë e këmbë e më nxorën jashtë. I mbuluar, gati për të m'u zënë fryma, ndieja shtrëngimin e duarve të babait dhe kërcitjen e hapave të tij mbi trotuar. Kur më në fund më zbuluan kokën, pashë se ndodheshim përpara një vile dykatëshe. Përtej kangjellës së hekurt, në oborrin e vogël, kishte pisha të larta që e kalonin edhe çatinë. Mbi portën e hyrjes që vendosur një tabelë prej bronzi, të cilën nuk mund ta lexoja, sepse ende nuk i kisha mësuar të gjitha shkronjat... Më vonë, meqë